

Drejtuar:  
Këshillit Mësimor-Shkencor të  
Fakulteti Ekonomik në kuadër të Universitetit të Tetovës

## RECENSION

UT - F.  
UT - Экономика  
14-669/1  
14.10.2024  
Tetovë

Për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës  
"EFEKTET E BASHKËVEPRIMIT TË POLITIKËS FISKALE DHE POLITIKËS  
MONETARE NË RRIJTJEN EKONOMIKE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË  
VERIUT" i punuar nga Mr. Sc. Imbërjah Tairi

Në bazë të neneve 110 dhe 136 të Ligjit Arsimin e Lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 82/18); neneve 158, 196 dhe 201 të Statutit të Universitetit të Tetovës (konform vendimit nr. 08-3719/1 të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 130/2019); neneve 46 dhe 78 të Statutit të Fakultetit Ekonomik dhe neneve 9 dhe 10 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe rregullat për regjistrim dhe studim në studimet e ciklit të tretë – studime të doktoratës në Universitetin e Tetovës, Këshilli Mësimor - Shkencor i Fakultetit Ekonomik i Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 25.02.2020, me vendim nr.14-242/1 të datës 03.03.2020 ka formuar Komision për shqyrtim të përshtatshmërisë së tezës dhe kandidatiit për propozim-temën e doktoratës "**Efektet e bashkëveprimit të politikës fiskale dhe politikës monetare në rritjen ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut**" të dorëzuar nga kandidati **Mr.Sc. Imbërjah Tairi**, në përbërje: **Prof. Dr. Ibish Mazreku, Prof. Dr. Etem Iseni, Prof. Dr. Arun Tairi.**

Pas shqyrtimit të fletaplikimit të kandidatit dhe procedurave të ndjekura nga ana e kandidatit, Komisioni në fjalë ka dalë me vlerësim pozitiv për përshtatshmërinë e tezës dhe kandidatit për propozimin e temës me titull "**Efektet e bashkëveprimit të politikës fiskale dhe politikës monetare në rritjen ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut**" dorëzuar nga kandidati **Mr.Sc. Imbërjah Tairi.**

Andaj Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Ekonomik ka sjellë vendim nr. 14-309/1 të datës 10.04.2020 për miratim të temës së propozuar nga ana e kandidatit dhe vendim nr. 14-309/2 të datës 10.04.2020 për emërimin e **Prof. Dr. Ibish Mazrekut** si mentor të kandidatit në fjalë.

Në bazë të nenit 201 të Statutit të Universitetit të Tetovës dhe nenit 62 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhe studimit në ciklin e tretë të studimeve - studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës, në mbledhjen e Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Ekonomik, të mbajtur më datë 18.07.2024, është sjellë vendim nr. 14-444/6 për formimin e komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës në këtë përbërje: **Prof. Dr. Brikend Aziri, Prof.Dr. Sheherzada Murati, Prof.Dr. Etem Iseni, Prof.Dr. Afrim Alili dhe Prof.Dr. Ibish Mazreku**. Pas leximit të punimit të dorëzuar të disertacionit dhe harmonizimit të mendimeve, Komisioni ka nderin të dorëzojë këtë:

## R A P O R T

### I

#### ANALIZA E PUNIMIT

Disertacioni i doktoratës së kandidatit **Mr.sc. Imbërjah Tairi**, mban titullin **"Efektet e bashkëveprimit të politikës fiskale dhe politikës monetare në rritjen ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut"**. Punimi është në përputhje me qasjen e përgjithshme metodologjike dhe është strukturuar në këtë radhitje:

- Hyrje
- Kreu I: Qasje teorike ndaj politikës fiskale
- Kreu II: Qasje teorike ndaj politikës monetare
- Kreu III: Bashkëveprimet e politikës fiskale dhe politikës monetare
- Kreu IV: Qasje teorike ndaj rritjes ekonomike
- Kreu V: Analizë e efektve dhe të bashkëveprimimeve midis politikës fiskale dhe politikës monetare në rritjen ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut

- Përfundime dhe rekomandime
- Shtojca
- Bibliografia

Në pjesën hyrëse të disertacionit të doktoraturës është përcaktuar objekti dhe arsyeimi i punimit, qëllimet dhe rëndësia e punimit, si dhe metodologjia hulumtuese.

Në kreun e parë, me titull "**Qasje teorike ndaj politikës fiskale**", trajtohet sistemi fiskal në përgjithësi dhe, me një vështrim të veçantë, sistemi dhe politika fiskale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke dhënë një shtjellim të plotë mbi funksionimin dhe menaxhimin e mjeteve buxhetore. Kandidati përshkruan instrumentet e politikës fiskale, siç janë të hyrat publike, të dalat publike dhe deficitin buxhetor, të cilat zënë një vend të veçantë në këtë kapitull. Hulumtimi është i bazuar në një qasje shumë të rëndësishme, ku shqyrtohen teoritë adekuate të bazuara në këto tematika. Të dhënat që do të shërbejnë për realizimin e qëllimit të hulumtimit do të jenë kryesisht dytësore (sekondare). Për të studiuar lidhjet dhe për të testuar hipotezat e parashtruara, do të përdoren të dhëna sekondare mujore dhe tremujore, kryesisht indikatorë makroekonomikë, të dhëna si seri kohore të grumbulluara nga raportet tremujore të Bankës Qendrore, si dhe buletinët e Entit Shtetëror Statistikor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në kreun e dytë, me titull "**Qasje teorike ndaj politikës monetare**", përshkruhet politika monetare në vendin tonë, pra në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nga aspekti teorik. Në këtë kapitull trajtohen qëllimet kryesore të politikës makroekonomike, siç janë sigurimi i rritjes së qëndrueshme ekonomike jo-inflacioniste në një ekonomi. Arritjet realizohen përmes përdorimit të instrumenteve të politikës ekonomike, ku më të rëndësishmet janë ato të politikës monetare.

Kandidati, në këtë kapitull, përshkruan dhe hulumton rolin e Bankës Qendrore, duke marrë parasysh faktin se në dekadat e fundit pavarësia e Bankës Qendrore është analizuar si një domosdoshmëri, për shkak të mungesës së besimit në politikat qeveritare anti-

inflacioniste. Një Bankë Qendrore e pavarur konsiderohet si institucion që kujdeset kryesisht për stabilitetin monetar. Kjo nënkupton se politikëbërja ekonomike është analizuar si një bashkëveprim midis krijuesve të pavarur të politikës monetare dhe politikës fiskale, të cilët shpesh kanë qëllime kontradiktore ose konfliktuoze.

Kreu i tretë, me titull "**Bashkëveprimet e politikës fiskale dhe politikës monetare**", përshkruan teorikisht politikat fiskale dhe monetare, të cilat janë dy politikat kyçe makroekonomike të aplikuara nga ekonomitë moderne të tregut. Kandidati shqyrton ndikimin e bashkëveprimit të politikës fiskale dhe asaj monetare në rritjen ekonomike, duke i referuar në mënyrë të veçantë gjendjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Hulumtimi dhe analiza e politikës fiskale dhe monetare, si dhe korrelacionet dhe ndikimi i bashkëveprimeve të tyre në rritjen ekonomike, është një temë komplekse dhe një fushë relativisht pak e hulumtuar. Kjo lë hapësirë për qasje të reja dhe arritjen e rezultateve që prezantohen në këtë disertacion doktorature.

Në kreun e katërt, me titull "**Qasje teorike ndaj rritjes ekonomike**", trajtohen koncepti, kuptimi dhe qasja ndaj faktorëve që ndikojnë në rritjen ekonomike. Këtu theksohet se rritja ekonomike udhëhiqet nga sistemi financiar (qasja e ofertës), sipas së cilës sistemi financiar ndikon në rritjen ekonomike duke rritur ofertën e shërbimeve financiare, çka sjell rritjen e aktiviteteve ekonomike. Një sistem financiar i pa zhvilluar mund të pengojë rritjen ekonomike, ndërsa një sistem financiar i zhvilluar kontribuon në rritje të qëndrueshme dhe të lartë ekonomike, për sa kohë nuk ka kufizime nga faktorë të tjerë.

Në këtë kapitull theksohet roli i sistemit bankar për të krijuar dhe drejtuar para në projekte produktive dhe inovative, të cilat nxisin rritjen ekonomike. Zhvillimi i sistemit financiar mund të bazohet edhe në qasjen e kërkesës, sipas së cilës rritja e kërkesave për shërbime financiare çon në zhvillimin e tregjeve dhe institucioneve financiare. Po ashtu, ekziston qasja e shkakësisë reciproke, që thekson një marrëdhënie të dyanshme ndërmjet zhvillimit financiar dhe rritjes ekonomike.

Kjo lidhje e ndërsjellë mund të përshkruajë një reagim midis sektorit financiar dhe atij real. Megjithatë, në rrethana të caktuara, zhvillimi i sistemit financiar mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike, për shkak të efekteve të krizave financiare. Sipas një pikëpamjeje tjetër, zhvillimi i sistemit financiar dhe rritja ekonomike nuk kanë lidhje shkakësore, duke sugjeruar se korrelacioni i tyre pozitiv mund të jetë thjesht rastësor.

Fushat kryesore të studimit që dalin nga tema kryesore e këtij punimi janë:

- prezantimi dhe kuptimi i postulateve teorike në lidhje me konceptet e politikës fiskale;
- prezantimi dhe kuptimi i postulateve teorike në lidhje me politikën monetare;
- prezantimi dhe kuptimi i postulateve teorike lidhur me zhvillimin ekonomik;
- prezantimi dhe kuptimi i postulateve teorike lidhur me bashkëveprimet ndërmjet politikës monetare dhe asaj fiskale;
- Shqyrtimi i ndikimit që rezulton nga bashkëveprimet ndërmjet politikës monetare dhe asaj fiskale në rritjen ekonomike.

Në kuadër të **kreut të pestë** (të fundit) të disertacionit të doktoraturës, bazuar në lëndën e hulumtimit dhe qëllimin e vendosur të hulumtimit, disertacioni i doktoratës bazohet në dy hipoteza të përgjithshme kërkimore, në kuadër të të cilave janë vendosur nga tre hipoteza të veçanta kërkimore, që janë paraqitur më poshtë:

**H1: Ekziston lidhje pozitive ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike.**

H1.1: Ekziston lidhje pozitive ndërmjet të hyrave publike dhe Bruto Prodhimit Vendor.

H1.2: Ekziston lidhje pozitive ndërmjet shpenzimeve publike dhe Bruto Prodhimit Vendor.

H1.3: Ekziston lidhje pozitive ndërmjet deficitit buxhetor dhe Bruto Prodhimit Vendor.

## **H2: Ekziston lidhje pozitive ndërmjet politikës monetare dhe rritjes ekonomike**

H2.1: Ekziston lidhje pozitive ndërmjet inflacionit dhe Bruto Prodhimit Vendor.

H2.2: Ekziston lidhje pozitive ndërmjet bilancit të pagesave dhe Bruto Prodhimit Vendor.

H2.3: Ekziston lidhje pozitive ndërmjet ofertës monetare dhe Bruto Prodhimit Vendor.

Kandidati analizon bashkëveprimin e politikës fiskale dhe politikës monetare në rritjen ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut duke përfshirë metodologjinë e përdorur për hulumtim, si dhe analizën dhe interpretimin e rezultateve të arritura.

Metodologjia e shfrytëzuar e kandidatit për realizimin e hulumtimit shkencor përfshin një sërë testimesh duke filluar nga testimi i stacionaritetit ku janë përfshirë Testi Augmented Dickey-Fuller (ADF) dhe Phillips Perron (PP), për të vërtetuar stacionaritetin e variablave të përfshira në studim. Rezultatet e këtij testimi janë paraqitur me metodën e VAR (Vector autocorrection) ose me gjetjen e vektorit kointegruar përmes aplikimit të Testit Johansen-Juselius për kointegrim dhe me ç'rast do të vazhdohet me metodën VAR (Vector Autoregression Model) që të kuptohet ekzistimi i lidhjes afatshkurtër ose VECM (Vector Error Correction Model) që të kuptohet ekzistimi i lidhjes afatgjatë midis inflacionit, bilancit tregtar, ofertës monetare, të hyrave, shpenzimeve publike, deficitit buxhetor dhe rritjes ekonomike.

Po ashtu, është hetuar lidhja kauzale midis variablave të lartpërmendura, ku është shfrytëzuar Testi Granger Causality, Wald Test dhe testet e tjera të nevojshme për arritjen e qëllimit të vendosur në hulumtim. Procesi i këtillë i hulumtimit mundëson të kuptohet që hulumtimi nuk ka për qëllim vetëm përcaktimin e ekzistimit të lidhjeve ndërmjet variablave të përcaktuara në hulumtimin shkencor, por njëkohësisht edhe përcaktimin e intensitetit të lidhjeve mes këtyre variablave.

Kandidati do të përshkruajë instrumentet e politikës fiskale dhe politikës monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu do të

analizohen në mënyrë të detajuar lidhjet që ekzistojnë ndërmjet bashkëveprimit të instrumenteve të politikës fiskale dhe politikës monetare në rritjen ekonomike të Maqedonisë së Veriut, të shprehura përmes vlerave dhe ecurisë së vlerave të Bruto Prodhimit Vendor. Po ashtu, do të realizohen matjet empirike të lidhjeve ekzistuese ndërmjet instrumenteve të politikës fiskale, politikës monetare dhe rritjes ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Rezultatet e dala nga hulumtimi, kandidati i ka interpretuar përmes paraqitjeve tabelare dhe grafike. Përdorimi paketës programore adekuate statistikore (STATA 12.0), i ka mundësuar matjen dhe vërtetimin e hipotezave bazë dhe marrjen e vendimit nëse pranohen ose refuzohen hipotezat bazë, gjegjësisht hipoteza alternative. Gjithashtu, rezultatet e fituara do të interpretohen të shoqëruara me të gjitha sqarimet e nevojshme për kuptim më të mirë që tregojnë domethënien dhe rëndësinë e tyre si dhe do të japin një indikacion mbi efektet kryesore të mundshme pozitive të politikës fiskale në rritjen ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në luftën kundër evazionit fiskal, krijimin e vetëdijes së opinionit dhe kulturës fiskale, kontribut të çmueshëm mund të japin edhe organizatat qeveritare dhe joqeveritare, shoqatat e afaristëve, mediat dhe institucionet e pavarura hulumtuese dhe shkencore. Duke analizuar të gjithë indikatorët, bazuar në kriteret dhe standardet e përcaktuara të politikave buxhetore dhe kredibilitetin buxhetor, transparencën buxhetore, kontrollin dhe ekzekutimin e shpenzimeve, regjistrimin dhe raportimin, revizionin e brendshëm dhe të jashtëm të shpenzimeve publike, konkludojmë se menaxhimi i shpenzimeve në periudhën në Maqedoninë e Veriut disponon kredibilitet të konsiderueshëm dhe është transparent. Megjithatë, ky proces kërkon evaluim vjetor të performancës së indikatorëve me qëllim të ruajtjes së qëndrueshmërisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm të tyre.

## II

### PËRMBUSHJA E KUSHTEVE LIGJORE PËR MBROJTJEN E PUNIMIT

Kandidati i plotëson kushtet e përcaktuara nga Ligji për Arsimin e Lartë, Statuti i Universitetit të Tetovës, si dhe Rregullorja për kushtet, kriteret dhe rregullat për regjistrimin dhe studimin në ciklin e tretë – studimet doktorale në Universitetin e Tetovës, për mbrojtjen e punës doktorale. Përveç përmbushjes së numrit të nevojshëm të kredive ECTS dhe përfundimit të të gjitha aktiviteteve të nevojshme të parashikuara për studimet e ciklit të tretë në programin studimor Shkenca Ekonomike, si autor kryesor ka botuar dy punime në publikime shkencore të referuara, dhe këto janë:

1. **Tairi, I.** (2023) *The impact of fiscal policy on economic growth in the Republic of North Macedonia*. Economic vision. International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism, 10 (19-20). pp. 125-131. ISSN 2545-4544.
2. **Tairi, I.** (2022). *Optimal coordination between fiscal and monetary policy*. International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism, 9 (17-18). pp. 81-89. ISSN 2545-4544.

## III

### REZULTATET PLOTËSUESE HULUMTUESE

Kandidati, si autor kryesor, për më tepër, gjatë punës së tij për disertacionin e doktoraturës ka marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe ka botuar edhe punime të tjera shkencore që lidhen ngushtë me fushën e disertacionit të doktoraturës, siç janë:

- 1) **Tairi, I.** (2024). *The impact of public revenues on economic growth in the Republic of North Macedonia*. 10 th International Scientific Conference of the Faculty of Economics. 7 th International Scientific Conference "Contemporary Economic Trends".
- 2) **Tairi, I.** (2023). *The impact of monetary policy on economic growth in the Republic of North Macedonia*. 10 th International Scientific Conference of the Faculty of Economics. 7 th International Scientific Conference "Contemporary Economic Trends".

- 3) **Tairi, I.** (2020). *Specificities of the Fiscal System in R. Macedonia.* International Scientific Conference Strategic Management and Decision Support Systems in Strategic Management. [https://doi.org/10.46541/978-86-7233-380-0\\_8](https://doi.org/10.46541/978-86-7233-380-0_8)
- 4) **Tairi, I.** (2019). *Specificities of the Fiscal System in R. Macedonia.* Proceedings: of the 24th International Scientific Conference Strategic Management and Decision Support Systems in Strategic Management.
- 5) **Tairi, I.** (2019). *The need for harmonization between monetary and fiscal policy in the context of achieving macroeconomic stability.* 7th International Scientific Conference "Contemporary Economic Trends".

Është e rëndësishme të theksohet se kandidati është angazhuar si bashkëpunëtor në Fakultetin Ekonomik dhe është i punësuar në shërbimin e integruar dhe profesional në Rektoratit e Universitetit të Tetovës, në fushën e menaxhimit të punës financiare dhe të kontabilitetit, ku drejton Departamentin e Punës Financiare - të Kontabilitetit, Investimeve dhe Zhvillimit. Ky angazhim i jep ekspertizë dhe përvojë në zbatimin e menaxhimit të buxhetit, një segment që është i pranishëm në hulumtimin e tij dhe që kandidati e ka aplikuar gjatë realizimit të disertacionit të doktoraturës.

Kandidati gjithashtu ka marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm trajnimesh dhe seminari në fushën e punës financiare dhe kontabël, duke përfshirë tema që trajtojnë si politikën fiskale, ashtu edhe atë monetare, duke dhënë një rezultat shtesë dhe mbështetje në ndërtimin dhe përmbylljen e këtij studimi që ka një rëndësi të veçantë, duke marrë parasysh faktin e pamohueshëm se ky studim nuk shqyrton vetëm një politikë, qoftë ajo fiskale apo monetare, por analizon korrelacionin e tyre dhe ndikimin e tij në zhvillimin ekonomik.

Studimet e tij themelore në fushën e studimeve ekonomike dhe studimet master në të njëjtën fushë, të cilat kandidati i ka përfunduar me sukses të veçantë, si dhe realizimi i suksesshëm i të gjitha aktiviteteve të parashikuara të studimeve doktorale, sipas ligjit, i kanë ofruar një bazë të fortë për realizimin e një hulumtimi të tillë.

**VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR**

Në bazë të analizës së punimit, Komisioni jep këto vlerësime përfundimtare lidhur me disertacionin e doktoratës së kandidatit Mr.Sc. IMBËRJAHTAIRI .

1. Tema e doktoratës me titull: "**EFEKTET E BASHKËVEPRIMIT TË POLITIKËS FISKALE DHE POLITIKËS MONETARE NË RITJEN EKONOMIKE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**" paraqet një hulumtim burimor dhe të pavarur të kandidatit që kontribuon në studimin e ndikimit të politikës fiskale dhe politikës monetare në vendin tonë.

2. Kandidati në punimin e tij ka arritur të bëjë një hulumtim serioz shkencor, si në aspektin teorik, ashtu edhe atë praktik, ka arritur të bëjë një analizë të thellë të faktorëve ndikues në rritjen ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

3. Teza e doktoratës përmbush standardet e nevojshme metodologjike, teknike dhe gjuhësore. Kandidati ka parashtruar qëllimet e punimit dhe ka arritur të bëjë zbërthimin e tezave kryesore të hulumtimit. Ajo ka përdorur një metodologji shkencore, ka treguar korrektësi në shfrytëzimin e burimeve, në citime dhe ka demonstruar qasjen kritike ndaj referencave bibliografike dhe citateve të autorëve të huaj. Gjithashtu, teza është shkruar me një stil dhe gjuhë të pasur dhe të kuptueshme për opinionin e gjerë.

4. Marrë në përgjithësi Komisioni njëzëri e vlerëson temën e doktoratës së kandidatit Mr.Sc. IMBËRJAHTAIRI .me titull "**EFEKTET E BASHKËVEPRIMIT TË POLITIKËS FISKALE DHE POLITIKËS MONETARE NË RITJEN EKONOMIKE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**" si të suksesshme dhe të pjekur për **MBROJTJE PUBLIKE**.

V

Në bazë të asaj që u theksua më lartë, komisioni njëzëri i jep këtë:

**PROPOZIM**

1. Punimi i doktoratës së Kandidatit Mr. Imbërjah Tairi me titull **"EFEKTET E BASHKËVEPRIMIT TË POLITIKËS FISKALE DHE POLITIKËS MONETARE NË RRITJEN EKONOMIKE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT"** është i pjekur për mbrojtje publike.
2. Propozohet që Këshilli i Fakultetit që të miratojë këtë raport, të lejojë mbrojtjen publike, të formojë Komisionin për mbrojtjen publike të disertacionit të doktoratës dhe të caktoj datën e mbrojtjes publike.

**KOMISIONI:**


1. Prof. Dr. Brikend Aziri (kryetar)




2. Prof. Dr. Sheherzada Murati (anëtar)



3. Prof. Dr. Etem Iseni (anëtar)



4. Prof. Dr. Afrim Alili (anëtar)



5. Prof. Dr. Ibish Mazreku (anëtar)

